



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr.39/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të datës 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.06.2026, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.39/2025, e datës 09.06.2026, parashtruar nga Subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës,, të datës 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Më datë 09.06.2026, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendojnë se me datë 07.06.2026, në ditën e votimit dhe gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, në mediumin online Gazeta Blic, është shfaqur reklamë politike e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës — LDK, me numrin zgjedhor 113, ku paraqiten kandidatët Vjosa Osmani dhe Lumir Abdixhiku, me numrat përkatës 1 dhe 2, si dhe me thirrjen politike "BASHKOHU!".

Më tej në ankesë theksohet se nga fotografia shihet qartë se reklama është shfaqur në faqen e Gazeta Blic në orën 12:31, pra gjatë kohës kur qendrat e votimit kanë qenë të hapura dhe kur heshtja zgjedhore është në fuqi. Po ashtu, mbi reklamë shihet edhe lajmi i publikuar për daljen e votuesve deri në orën 11:00, gjë që e vendos këtë publikim qartazi brenda ditës së votimit.

Reklama e tillë përmban elemente të drejtpërdrejta të fushatës zgjedhore: logon dhe numrin e subjektit politik, emrat dhe fotografitë e kandidatëve, numrat e tyre në listë dhe mesazh mobilizues politik.

Në këtë rast, shkelja është edhe më e rëndë për faktin se nuk bëhet fjalë për një postim individual në rrjet social, por për reklamë politike të vendosur në medium online, e cila i shfaqet publikut e gjerë në ditën kur votuesit tashmë janë duke ushtruar të drejtën e votës. Kjo krijon përparësi të palejueshme për subjektin politik të reklamuar dhe cenon parimin e barazisë së subjekteve politike gjatë ditës së votimit.

Heshtja zgjedhore ka për qëllim mbrojtjen e vullnetit të lirë të votuesit në momentin më të ndjeshëm të procesit zgjedhor. Gjatë kësaj periudhe, votuesi duhet të jetë i lirë nga presioni, thirrjet, reklamat dhe mesazhet e reja propaganduese të subjekteve politike. Prandaj, çdo reklamim politik në ditën e votimit, sidomos në media online me qasje publike, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të rregullave zgjedhore,

Prandaj, kërkojnë nga PZAP-i që të aprovojë si të bazuar këtë ankesë, të shqiptojë masat ndëshkuese të parapara me ligj dhe rregullore ndaj subjektit politik përgjegjës.

Si prove kanë bashkangjitur 2 fotografi.

Në përgjigje në ankesë të Subjekti Politik LDK sqarojnë se i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në ankesën e LVV së si të pabazuara në fakte dhe në të drejtën e aplikueshme. Ankesën e paraqitur e kundërshtojnë në tërësi, si të pabazuara në fakte dhe prova.

Në përgjigje theksohet se ankuesi ka bashkëngjitur vetëm fotografi (screenshot-e) në të cilat paraqiten kandidatë të LDK-së në publikime të një portali mediatik. Megjithatë, nga provat e paraqitura nuk rezulton se publikimet kanë qenë reklama aktive gjatë ditës së zgjedhjeve, nuk rezulton statusi i tyre si aktive apo joaktive, koha e saktë e shpërndarjes, sponsorizuesi i tyre, nuk rezulton as cila ditë është pasi ne foto shihet ora dhe një screenshot por ky screen shot ne cilën dite ka qene apo ndonjë e dhënë tjetër që do të dëshmonte zhvillimin e aktivitetit zgjedhor nga ana e LDK-së ose kandidatëve të saj.

Veçanërisht, provat e bashkëngjitura tregojnë se përmbajtja e pretenduar është publikuar nga portali mediatik dhe jo nga LDK-ja apo kandidatët e saj. Ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë që LDK-ja ose kandidatët kanë administruar, kontrolluar, porositur, financuar apo autorizuar publikimin në fjalë, Paraqitja e kandidatëve në një medium informues nuk krijon automatikisht përgjegjësi për subjektin politik, përderisa nuk provohet lidhja e drejtpërdrejtë e tij me publikimin. Pastaj portali ne fjale nuk është i portal i LDK, por portal i pavarur dhe privat.

Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë se publikimi i pretenduar ka qenë reklamë e sponsorizuar nga LDK-ja ose kandidatët e saj. Mungon çdo dëshmi që do të vërtetonte pagesë, autorizim, koordinim apo çfarëdo forme të përfshirjes së LDK-së në publikimin e përmbajtjes nga portali. Në mungesë të provave të qarta, të besueshme dhe të mjaftueshme dëshmojnë se LDK ose kandidatët e saj kanë zhvilluar aktivitet zgjedhor gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore,

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar

Parashtruesi i ankesës Subjekti Politik LVV në ankesën e tij ka theksuar se Subjekti Politik LDK, gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, në mediumin online Gazeta Blic, është

shfaqur reklamë politike e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës — LDK, me numrin zgjedhor 113, ku paraqiten kandidatët Vjosa Osmani dhe Lumir Abdixhiku, me numrat përkatës 1 dhe 2, si dhe me thirrjen politike "BASHKOHU!" Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të nenit 37 par. 1 pika 2 i LZP-së, apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024.

Në rastin konkret në provën e bashkangjitur si dëshmi nuk shihet ndokund data 07 Qershor 2026, për të cilën pretendohet si datë e publikimit të shfaqjes në mediumin online Gazeta Blic, të kandidatëve Vjosa Osmani dhe Lumir Abdixhiku. PZAP, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin parasheh "Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme", ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pabazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në mediumin online, Gazeta Blic, nuk është gjetur asnjë postim për të cilin pretendohet në ankesë, apo se postimi i pretenduar është postuar pikërisht gjatë ditës së zgjedhjeve. Andaj bazuar në ato që u tha Paneli nuk ka gjetur shkelje të dispozitave të lartcekura të LZP-së apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që nga prova e ofruara si dëshmi të cilën parashtuesi i ankesës e ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese,

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse".

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 par. 1 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.39/2025 më datën 11.06.2026

**Kryesues i Panelit,
Skender Çoçaj**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.